



ASDO
ALBANIA SUSTAINABLE
DEVELOPMENT ORGANIZATION

agROtech

Plani Strategjik 2023-2026

agROtech





Fjala e kryetares

Është kënaqësi të prezantoj iniciativën agROtech dhe strategjinë zhvillimore të saj. Strategjia e agROtech është hartuar për të realizuar informimin e palëve të interesit dhe të gjithë vendimmarrësit përkatës dhe grupet e interesuara mbi tendencat aktuale të zhvillimit teknologjik në fushën agro që Bashkia Roskovec po ndërmerr. Ky dokument ofron gjithashtu një pasqyrë të shkurtër të masave të përfunduara, të vazhdueshme dhe të planifikuara të Bashkisë, publikut të gjerë, komunitetit të biznesit dhe donatorëve që synojnë adresimin e çështjeve të inovacionit, mbështetjes së startupeve dhe sektorit agro.

agROtech është një iniciativë ndërsektoriale që ndërthur mundësitë që ofron teknologjia me nevojat që ka sektori agro. Strategjia që po ju prezantojmë ka si qëllim zhvillimin e sektorit agro në përputhje me objektivat dhe parimet e zhvillimit të qëndrueshëm. Niveli i zhvillimit teknologjik dhe i implementimit të ideve inovatore në sektorin agro në rajonin e Roskovecit është ende i ulët në krahasim me rajone të tjera në Shqipëri. Megjithatë, Bashkia Roskovec është e angazhuar të marrë masa për të rritur kapacitetet në sektor, në harmoni me zhvillimin e sektorëve të tjerë ekonomikë, si energjia dhe transporti, përdorimi i tokës dhe pylltaria, proceset industriale dhe mbetjet, duke synuar arritjen e objektivit të ri të zgjeruar në përgjigje të objektivave kombëtare të zhvillimit.

Kjo strategji është bazuar në një analizë sistematike të hartimit të planeve strategjike, duke përfshirë elementët kryesorë si vizioni, misioni, objektivat strategjike, dhe analizën SWOT. Ajo gjithashtu merr në konsideratë kapacitetet ekzistuese të Bashkisë dhe planet e ardhshme të veprimit për të përmbushur objektivat afatmesme dhe afatgjata zhvillimore të rajonit.

Përmbajtja kryesore e Strategjisë u diskutua përmes grupeve kryesore të interesit: bizneset agro, komuniteti, të rinjtë dhe shoqëria civile. Të gjitha sugjerimet dhe komentet e marra janë analizuar tërësisht dhe, për aq sa është e mundur, janë adresuar. Dëshiroj të shpreh mirënjohjen për donatorin kryesor të projektit, Ministrin e Shtetit për Sipërmarrjen, dhe të përgëzoj të gjithë ata që janë përfshirë në procesin e përgatitjes dhe zbatimit të projektit agROtech, veçanërisht organizatën partnere në zbatimin e projektit, Qendrën Shqiptare për Zhvillim të Qëndrueshëm (A.S.D.O).

Majlinda Bufi

Roskovec, Dhjetor 2022



ASDO
ALBANIA SUSTAINABLE
DEVELOPMENT ORGANIZATION

Përmbajta

1	Bashkia Roskovec.....	3
	Të dhëna demografike dhe gjeografike	3
	Kuadri ligjor mbi të cilën ushtron veprimtarinë e saj Bashkia Roskovec	3
2	Qendra agROtech.....	4
	Detyrat funksionale	4
	Struktura dhe organizimi	5
	Vizioni, misioni dhe vlerat.....	6
	Vizioni.....	6
	Misioni	6
	Parimet dhe vlerat	6
3	Objektivat strategjike 2023-2026	8
	Objektivat specifike	9
4	Analiza SWOT.....	10
	Fuqitë	10
	Dobësitë	11
	Mundësitë.....	12
	Kërcënimet/rreziqet	13
5	Plani i veprimit	14
	Monitorimi i strategjisë.....	14
	Mbështetja e startup-eve dhe prioritizimi i projekteve të tyre.....	14
	Vendimmarrja, konsultimet publike dhe pjesëmarrja e komunitetit	16
	Shtojca 1: Propozimi mbi planin e aktiviteteve për t'u përmbushur nga Bashkia Roskovec për të siguruar qëndrueshmërinë e Qendrës agROtech.....	18
	Shtojca 2: Indikatorët e monitorimit të planit strategjik të Qendrës agROtech për t'u përmbushur nga Bashkia Roskovec për periudhën 2023-2026.....	21

1 Bashkia Roskovec

Të dhëna demografike dhe gjeografike

Bashkia e re Roskovec kufizohet në veri dhe perëndim me bashkinë Lushnjë, në jug me bashkinë Mallakastër, në lindje me bashkinë Ura Vajgurore, ndërsa në perëndim me bashkinë Patos. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Roskovecit.

Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia e re Roskovec ka 21.742 banorë ndërsa në Regjistrin Civil popullsia e regjistruar figuron 31.548 banorë. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 118.01 km². Në bazë të popullsisë së numëruar nga censusi, densiteti i popullsisë së bashkisë së re është 184 banorë për kilometër katror ndërsa në bazë të regjistrit civil densiteti rezulton 263.33 banorë/ km².

Bashkia e re e Roskovecit shtrihet pjesërisht mbi zonën naftëmbajtëse Patos- Marinzë, e cila njihet si burimi më i madh i naftës në Evropën kontinentale. Pjesë e bashkisë së re do të jetë komuna Kurjan, e cila përfshin edhe fshatin Marinzë, që njihet veçanërisht si zonë naftëmbajtëse. Në këto kushte edhe të ardhurat kryesore të banorëve vijnë nga ky sektor, në të cilin janë punësuar shumë prej banorëve të zonës. Gjithashtu, njësitë e tregtimit dhe shërbimeve janë një tjetër sektor ku janë punësuar shumë prej banorëve të qytetit të Roskovecit. Sa i takon zonave rurale, të ardhurat fitohen kryesisht nga prodhimet bujqësore dhe agrumet. Në tabelën e mëposhtme jepni disa statistika mbi numrin total të bizneseve që operojnë në Bashkinë Roskovec, të cilat potencialisht mund të jenë përdoruese të shërbimeve dhe produkteve të ofruara pranë Qendrës agROtech, shërbime të cilat janë listuar në vijim të këtij dokumenti.

Njësia administrative	Kuman	Kurjan	Strum	Roskovec	Total
Biznese	84	26	143	243	496

Qyteti i Roskovecit ka përfituar disa projekte publike të financuara nga qeveria qendrore gjatë viteve të fundit për zhvillimin e infrastrukturës rrugore brenda qytetit, si dhe për ndërtimin e shkollave dhe qendrave shëndetësore, qendrave rinore etj.

Kuadri ligjor mbi të cilën ushtron veprimtarinë e saj Bashkia Roskovec

- ✓ Ligji nr.8548, datë 11.11.1999 “Për ratifikimin e Kartës evropiane të autonomisë vendore”;
- ✓ Ligj nr. 38/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;

- ✓ Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” si dhe Ligji nr.115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar).

2 Qendra agROtech

Detyrat funksionale

agROtech synon të përmbushë nevojën për të harmonizuar të gjitha projektet e Bashkisë së Roskovecit në një vizion të përbashkët dhe koherent të fokusuar në disa fusha parësore. agROtech ka një rol mbështetës, jo vetëm si katalizator për të nxitur zhvillimin e ideve në fushën e teknologjisë informacionit dhe komunikimit, por edhe për të ndihmuar të rinjtë dhe sipërmarrësit në përdorimin e teknologjisë më të fundit. Shërbimet e ofruara nga agROtech synojnë të promovojnë dhe mbështesin përfshirjen sociale duke mundësuar zhvillimin e programeve të qëndrueshme teknologjike të të rinjve duke rritur përfshirjen e tyre aktive në sipërmarrjen në TIK, duke nxitur krijimtarinë, inovacion dhe aktivitete konkurruese përmes ngritjes së kapaciteteve, zhvillimit të partneritetit dhe rritjes së ideve të Startupe-ve. Për më tepër Qendra agROtech lejon të rinjtë e Roskovecit dhe sipërmarrësit të njihen me agrobiznesin dhe teknologjinë, duke përfshirë:

- ✓ fermerët e tjerë që operojnë pranë Bashkisë Roskovec,
- ✓ pajisjet dhe softuerët,
- ✓ grupet e tjera të interesit apo dhe institucionet që hartojnë politika, duke komunikuar dhe ndër vepruar me njëri-tjetrin.

Qendra synon të bashkojë njohuritë dhe informacionet në fushën e teknologjisë për të rinjtë dhe sipërmarrësit që operojnë kryesisht fushën agro në mënyrë që të gjenerojë zgjidhje për problemet me të cilat përballet fusha agro dhe të plotësojë nevojat e tyre. Ekspertiza e kombinuar së bashku me nevojat e identifikuar të sektorit agro çojnë në gjenerimin e ideve dhe zgjidhjeve të ndryshme në favor të fermerëve dhe sipërmarrësve të rinj në fushën agro.

agROtech është e pajisur me një seri pajisjesh që përmbushin më së miri nevojat dhe dëshirën teknologjike të të rinjve dhe sipërmarrësve sot. Pranë Qendrës agROtech është krijuar një kënd i pajisur me kompjuterë dhe monitorë, printer/skaner/fotokopje, projektor, si dhe pajisje të tjera të zhvillimit teknologjik. Në secilin prej kompjuterëve janë të instaluar një sërë

programesh që do të ndihmojnë fëmijët, të rinjtë dhe sipërmarrësit të aftësohen më tej në fushën e TIK në mënyrë individuale.

Më konkretisht, detyrat funksionale të agROtech janë:

- ✓ Ngritja e kapaciteteve dhe aftësive të të rinjve dhe sipërmarrësve të Bashkisë Roskovec në gjetjen e zgjidhjeve novatore për problemet e bizneseve në fushën agro apo dhe në fushën e teknologjisë dhe informacionit;
- ✓ Planifikimi, hartimi i projekteve në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit dhe në fushën agro nga të rinjtë dhe sipërmarrësit e qytetit;
- ✓ Ofrimi i infrastrukturës teknike për sipërmarrësit e rinj apo dhe startupet që dëshirojnë të zhvillojnë një ide biznesi;
- ✓ Nxitja, promovimi, mbështetja dhe organizimi i aktiviteteve rinore dhe në fushën e teknologjisë;
- ✓ Ofrimi i infrastrukturës teknologjike për zhvillimin e trajnimeve apo dhe orëve ekstrakurrikulare nga mësuesit e Bashkisë Roskovec;
- ✓ Organizimi dhe implementimi i aktiviteteve për rritjen e kapaciteteve të të rinjve dhe nxënësve të shkollave në fushën e teknologjisë;
- ✓ Organizimi dhe implementimi i aktiviteteve për rritjen e kapaciteteve për sipërmarrësit në fushën e teknologjisë;
- ✓ Organizimi dhe implementimi i aktiviteteve që mbështesin sipërmarrësit gjatë procesit të transformimit të tyre digjital;
- ✓ Transformimi i mjediseve publike, nëpërmjet planifikimit dhe projekteve, në qendra teknologjike të frekuentueshme nga çdo grup moshë
- ✓ Zhvillimi, administrimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve dhe softuerëve që janë instaluar brenda Qendrës agROtech të Bashkisë Roskovec;
- ✓ Mirëmbajtja, përditësimi i platformës agROtech nga stafi i komunikimit apo dhe i teknologjisë së informacionit të Bashkisë Roskovec.

Struktura dhe organizimi

agROtech është organizuar në disa nivele drejtuese, duke ndarë detyra specifike sipas drejtorive të ndryshme. Në kohën e hartimit të strategjisë, 1 punonjës më kohë të plotë dhe 3 ekspertë të nënkontraktuar gjatë zbatimit të projektit janë angazhuar në zbatimin e aktiviteteve



ASDO
ALBANIA SUSTAINABLE
DEVELOPMENT ORGANIZATION

të parashikuara pranë agROtech. Vendimmarrja dhe funksionimi i drejtorive të ndryshme në Bashkinë Roskovec realizohet nëpërmjet një strukture piramidale menaxhimi, ku specialitete të ndryshme përfshihen në drejtori të ndryshme, nën varësinë e një drejtori të përgjithshëm. Organizimi i drejtorive të Bashkisë ndjek logjikën e funksioneve që ajo ushtron, duke ndarë linjat kryesore të veprimit të saj në njësi dhe drejtori të veçanta të lidhura me shërbimet mbështetëse të përfshira në strukturën drejtuese të Bashkisë.

Vizioni, misioni dhe vlerat

Vizioni

“Nuk jemi një qytet i vogël. Në Roskovec, njerëzit vlerësohen dhe kanë akses në njohuri digjitale, shërbime TIK, dhe infrastrukturë cilësore”

Misioni

Në thelb të punës dhe veprimtarisë së saj Bashkia Roskovec dhe agROtech ka qytetarin, krijimin e kushteve të një mjedisi që lehtëson aftësimin në fushën e teknologjisë dhe inovacionit.

Nëpërmjet aktivitete të zhvilluara në tre muajt e zbatimit të projektit agROtech është punuar në vendosjen dhe zhvillimin e një marrëdhënie të të rinjve dhe sipërmarrësve me teknologjinë inovacionit dhe njohuritë digjitale.

Vizioni i agROtech kërkon/synon zhvillimin e një kulture digjitale tek të rinjtë, fëmijët dhe sipërmarrësit e ardhshëm për të respektuar dhe zhvilluar punën e nisur.

Parimet dhe vlerat

Parimet dhe vlerat të cilat kanë udhëhequr procesin e hartimit të këtij plani strategjik janë edhe parimet dhe vlerat mbi të cilat Bashkia Roskovec ka si udhëheqës të punës së saj.

Hartimi i Planit Strategjik është udhëhequr nga parimet:

- **Zhvillimi i qëndrueshëm:** ky parim ka udhëhequr gjithë procesin e hartimit të këtij Planit Strategjik, sepse zhvillimi i qëndrueshëm është përfshirë gjithmonë e më shumë në politikat kombëtare e lokale në Shqipëri. Pra, është e rëndësishme që shfrytëzimi i burimeve të bëhet në një mënyrë sa më të balancuar dhe nëpërmjet një planifikimi të integruar për të arritur zhvillim ekonomik dhe social që garanton qëndrueshmëri në

kohë dhe jetëgjatësi.

- **Bashkërendimi:** Ky Plan Strategjik ka synuar të koordinohet me planet strategjike të Bashkisë së Roskovec. agROtech është në harmoni me interesat e biznesit dhe shoqërisë civile duke promovuar forma të ndryshme bashkëpunimi për një zhvillim të qëndrueshëm. Po ashtu, plani hartohet në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve (2021–2027) si dhe në përputhje me Ligjin Nr. 25/2022 Për mbështetjen dhe zhvillimin e Startup-eve.
- **Monitorimi:** Qëllimet dhe objektivat strategjike, të përcaktuara në këtë Plan Strategjik janë përkthyer në projekte dhe aktivitete specifike të matshme nëpërmjet treguesve të performancës, duke i bërë këto objektiva lehtësisht të matshme dhe të monitorueshme.
- **Gjithë përfshirja:** Plani Strategjik ka patur në fokus kryesor filozofinë e gjithë përfshirjes së qytetarëve, me një vëmendje të lartë në rritje e kapaciteteve të të rinjve dhe sipërmarrësve në fushën e teknologjisë së informacionit dhe agrikulturës. Kjo nënkupton krijimin e mundësive të barabarta për të gjithë qytetarët e Roskovecit dhe grup moshave të ndryshme duke i ndihmuar ata në arritjen e mirëqenies së përbashkët.
- **Fleksibiliteti:** Duke marrë në konsideratë, reformat e shumta që Qeveria Shqiptare ka ndërmarrë gjatë pesë viteve të fundit dhe ndryshimet thelbësore që kanë prekur funksionet dhe kompetencat e Njësive të Qeverisjes Vendore, objektivat strategjike dhe projektet janë hartuar duke marrë parasysh disa skenarë zhvillimi për të arritur përmbushjen më optimale të tyre edhe gjatë periudhave të tranzicionit.

Hartimi i Planit Strategjik bazohet në vlera të cilat udhëheqin punën e përditshme të agROtech. agROtech është i angazhuar, duke ofruar:

- **Qasje e barabartë:** agROtech beson se kushdo që jeton në zonat urbane apo dhe rurale duhet të ketë qasje të një cilësie të barabartë në edukim dhe t'i ofrohen mundësi të larmishme e të përballueshme në mjedise të krijuara dhe të sigurta teknologjike. Të gjithë anëtarët e agROtech të cilët kanë dëshirë të frekuentojnë qendrën apo të bëhen pjesë e trajnimeve të saj duhet të kenë mundësi zgjedhje për temat e trajtuara si dhe të pasurojnë njohuritë e tyre.
- **Financim të barabartë:** Bashkia Roskovec mbështet me buxhete ofrimin e shërbimeve në Qendrën agROtech në mënyrë të barabartë. Bashkia u jep prioritet

projekteve dhe nevojave për trajnim në zonat dhe komunitetet e nënvleftësuara më shumë në mënyrë strategjike për të adresuar sa më mirë barazinë sociale, raciale dhe ekonomike të qytetarëve.

- **Mbështetje dhe udhëzim për zhvillimin e Startup-eve:** Nëpërmjet agROtech mbështeten dhe udhëzohen të gjithë sipërmarrësit dhe të rinjtë me ide inovatore. Prandaj, në përputhje me parimet e qendrës, ofrimi i konsulencës së vazhdueshme në rritjen profesionale të inovatorëve të rinj është një objektivi i përhershëm i zhvillimit të aktivitetit.
- **Pjesëmarrje të komunitetit:** agROtech ofron mbështetje dhe hartim projektesh dhe programesh të frymëzuara nga komuniteti dhe nga sipërmarrësit që shërbejnë dhe pasqyrojnë shumëllojshmërinë e ideve në fushën e teknologjisë së informacionit dhe fushës agro. Ne kthejmë në projekte dëshirat dhe iniciativat që vijnë nga komuniteti.

3 Objektivat strategjike 2023-2026

Objektivat strategjike të agROtech mbështeten në deklaratat e vizionit dhe misionit të saj si edhe janë në linjën e objektivave e Bashkisë Roskovec dhe në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve (2021–2027) si dhe Ligjin Nr. 25/2022 “Për mbështetjen dhe zhvillimin e Startup-eve”. Janë zhvilluar dhe objektiva specifike për secilin nga objektivat strategjike.

- ✓ **Objektivi I: Sigurimi i programeve dhe shërbimeve inovatore, të diversifikuara, gjithëpërfshirëse dhe të aksesueshme nga inovatorët, bizneset mikro dhe të vogla dhe të rinjtë;**
- ✓ **Objektivi II: Diversifikimi i strategjive dhe burimeve të financimit për aktivitetet dhe shërbimet e ofruara nga agROtech ;**
- ✓ **Objektivi III: Mbështetja dhe investimi në zhvillimin e kapaciteteve njerëzore përmes trajnimeve praktikave, dhe workshopeve;**
- ✓ **Objektivi IV: Zgjerimi dhe përforcimi i partneriteteve me aktorë të botës së biznesit dhe me grupe të tjera interesi;**
- ✓ **Objektivi V: Zhvillimi dhe zbatimi i një strategjie komunikimi që thekson imazhin, përmirëson pozicionimin dhe promovon aktivitetet dhe shërbimet e agROtech.**

Objektivat specifike

- ✓ Miradministrimi i këndit agROtech dhe i pajisjeve të instaluara;
- ✓ Ngritjen e kapaciteteve teknike të punonjësve dhe specialistëve të qendrës për mirëmbajtjen dhe organizimin e aktiviteteve në të ardhmen;
- ✓ Evidentimi i nevojave për ngritje kapacitetesh në të ardhmen për komunitetin e sipërmarrësve dhe të rinjve të Bashkisë Roskovec;
- ✓ Hartimi i projekteve sipas fushave parësore dhe ngritja e fondeve për mbështetjen e start-upeve në fushën agro apo dhe të teknologjisë;
- ✓ Dhënia në përdorim e pajisjeve dhe infrastrukturës së qendrës sipërmarrësve të rinj apo dhe startup-eve për aktivitete të ndryshme, të cilat do t'i lehtësojnë procesin e të bërit biznes;
- ✓ Promovimi e të rinjve të talentuar dhe të pasionuar pas teknologjisë, duke u krijuar mundësi dhe shërbime për aktivitete krijuese dhe novatore;
- ✓ Konsultimi me komunitetin, që do të evidentojë fusha të reja veprimi, aktivitete të reja për komunitetin, linja të reja shërbimesh në funksion të kërkesave të sipërmarrësve dhe të rinjve;
- ✓ Zhvillimi i mekanizmave të reja të financimit, të cilat synojnë financimin e aktiviteteve të start-upeve dhe të vetë qendrës;
- ✓ Promovimi i infrastrukturës së këndit agROtech për përthithjen e eventeve të rëndësishme me pjesëmarrje të sipërmarrësve apo dhe organizatave jo fitimprurëse;
- ✓ Promovimi i projekteve novatore të realizuara nga të rinjtë e talentuar apo dhe sipërmarrësit që kanë frekuentuar qendrën agROtech tek palët e interesit;
- ✓ Ofrimi i një infrastrukture teknologjike duke dhënë me qira pajisjet me kosto me të ulët;
- ✓ Ofrimi i një platforme komunikimi për përmirësimin e infrastrukturës për sipërmarrësit e rinj.

4 Analiza SWOT

Pas paraqitjes së kontekstit të zhvillimit të aktivitetit të agROtech, organizmit dhe funksionimit të saj, dhe parashtrimit të objektivave strategjike, kjo pjesë paraqet analizën SWOT. Analiza SWOT (ose matrica SWOT) është një teknikë e planifikimit strategjik që përdoret për të ndihmuar një organizatë të identifikojë pikat e forta, të dobëta, si edhe mundësitë dhe kërcënimet që lidhen me aktivitetin e saj. Ajo ka për qëllim të specifikojë objektivat e një organizate dhe të identifikojë faktorët e brendshëm dhe të jashtëm që janë të favorshëm dhe të pafavorshëm për arritjen e këtyre objektivave.

Fuqitë dhe dobësitë janë zakonisht të lidhura më mjedisin e brendshëm të një organizate, ndërsa, ndërsa mundësitë dhe rreziqet zakonisht përqendrohen në mjedisin e jashtëm. Emri është një akronim për katër parametrat që teknika ekzaminon:

- Fuqitë (strengths): karakteristikat e organizatës që i japin asaj një avantazh ndaj të tjerëve;
- Dobësitë (weakness): karakteristikat e organizatës që vendosin atë në një disavantazh në krahasim me të tjerët;
- Mundësitë (opportunities): elementë në mjedis që organizata mund t'i shfrytëzojnë në avantazhin e saj;
- Rreziqet/Kërcënimet (threats): elementë në mjedis që mund të shkaktojnë probleme për organizatën.

Identifikimi dhe realizimi i analizës SWOT është i rëndësishëm sepse ajo mund të informojnë hapat e mëvonshëm në planifikimin për të arritur objektivat strategjike.

Lidhur me aktivitetin dhe funksionet e agROtech është vlerësuar e rëndësishme realizimi i analizës SWOT për mbështetjen e procesit të planifikimit strategjik.

Fuqitë

Imazh i mirë publik – Njëpërmjet strategjive dhe një plani të kujdesshëm të hartuar të komunikimit, agROtech ka krijuar një imazh të mirë publik dhe ka arritur një nivel të mirë promovimi të aktiviteteve të saj. Kjo mundëson sigurimin e një mbështetjeje më të madhe të publikut për zbatimin e aktiviteteve të saj të ardhshme.

Staf i kualifikuar dhe i përkushtuar –Procesi i rekrutimit nëpërmjet një ofertë publike ka mundësuar nënkontraktimin e një organizate për ofrimin e trajnimeve dhe workshopeve e cila



në përbërje të saj ka staf dhe ekspertë të kualifikuar dhe të aftë në realizimin e detyrave specifike.

Bashkëpunimi me sektorin publik dhe përfshirja e sektorit privat –Aktivitete të agROtech përgjatë muajit Shtator, Tetor dhe Nëntor janë realizuar me mbështetjen financiare të Ministrisë të Shtetit për Sipërmarrjen. Duhet theksuar që në këto aktivitete kanë qenë pjesëmarrës 20 sipërmarrës nga sektori privat në fushën agro.

Përfshirja e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm në hartimin e planeve dhe objektivave – Zhvillimi i qëndrueshëm është në themel të hartimit të planeve dhe objektivave të kësaj strategjie. Përqafimi i kësaj filozofie përbën një aspekt shumë pozitiv për kohë që zhvillimi i qëndrueshëm është në themel të hartimit të politikave publike në mbarë botën.

Shfrytëzimi i teknologjisë së informacionit – përdorimi i medias sociale online, dhe aplikacioneve online për informimin mbi aktivitetet e saj, promovimin e imazhit, etj., konsiderohet si një përparësi në strategjinë e komunikimit pasi i bën më të aksesueshme aktivitetet, si edhe tërheq veçanërisht grup moshat e reja të popullsisë.

Infrastrukturë bashkëkohore për zhvillimin e aktiviteteve – agROtech është e pajisur me një seri pajisjesh që përmbushin më së miri nevojat dhe dëshirën teknologjike të të rinjve dhe sipërmarrësve sot. Pranë qendrës agROtech është krijuar një kënd i pajisur me kompjuter dhe monitor, printer/skaner/fotokopje, projektor, si dhe pajisje të tjera të zhvillimit teknologjik. Në secilin prej kompjuterëve janë të instaluar një sërë programesh që do të ndihmojnë fëmijët, të rinjtë dhe sipërmarrësit të aftësohen më tej në fushën e TIK në mënyrë individuale.

Dobësitë

Përqendrim më i madh në aktivitetet të njohurive digjitale – Aktivitetet e agROtech janë fokusuar më së shumti në njohuritë digjitale në përgjithësi, duke mos veçuar specifikisht teknologjitë e reja në sektorin agro.

Konsultim publik –Ndërsa gama e aktiviteteve është e gjerë, është i nevojshëm konsultimi më i gjerë publik në lidhje me aktivitetet e ndryshme të ndërmarra nga agROtech në mënyrë që të lëvrohen ide edhe nga publiku më i gjerë.

Financim i kushtëzuar dhe buxhet i kufizuar – Aktivitetet e agROtech janë të financuara nga Buxheti i shtetit, më konkretisht nga Ministri i Shtetit për Sipërmarrjen. Mbas përfundimit të projekti duhet të vendosen rrënjët për krijimin e një burimi të qëndrueshëm financimi, i cili do të lejonte rritjen e pavarësisë financiare të qendrës dhe mbështetjen e plotë dhe të



pakushtëzuar të aktiviteteve dhe projekteve të saj. Për më tepër, nisur dhe nga buxheti shpesh herë i kufizuar dhe i pamjaftueshëm i Bashkive në të ardhmen mund të mos realizohen të gjitha objektivat dhe planet e Qendrës agROtech.

Kohë e shkurtër që nga themelimi – agROtech është krijuar në shtator 2022, gjë që do të thotë që qendrës i mungon tradita dhe eksperiencia në ushtrimin e aktiviteteve të saj. Pavarësisht kësaj agROtech përfitoi nga eksperiencia e stafit të nënkontraktuar të ekspertëve. Gama e gjerë e aktiviteteve ka ardhur duke u shtuar që nga koha e krijimit.

Planifikim i pambështetur në një analizë të nevojave të zonës– Projektet e reja duhet të mbështeten në studime dhe analiza të nevojave, në mënyrë që të jenë të fokusuara në nevoja specifike të sektorit agro.

Mungesa në burime njerëzore – Pavarësisht se stafi i bashkisë ka ardhur gjithmonë në rritje, ka nevojë për staf shtesë për të mundësuar realizimin me efektivitet të aktiviteteve të qendrës agROtech.

Mundësitë

Më shumë aktivitete për t'u zhvilluar – Praktikant më të mira botërore në fushën e hub-eve dhe të lehtësimit të startupeve dhe sipërmarrjeve në fushën agro japin ide për zhvillimin e aktiviteteve të reja, të cilat shënjestrojnë shumë grupe të popullsisë, si: të rinjtë, fëmijët e pasionuar pas teknologjisë, sipërmarrësit e rinj apo dhe sipërmarrës ekzistues në treg etj. Në këtë kuadër, zhvillimi i mekanizmave të reja të financimit, të cilat synojnë financimin e aktiviteteve të qendrës është një domosdoshmëri. Disa qasje për financimin novativ mund të përqendrohen në drejtim të: tarifave të shfrytëzimit të pajisjeve dhe shërbimeve, qirave, si dhe bashkëpunimeve të përqendruara në nivel lokal ndërmjet sektorit privat, autoriteteve qeveritare dhe komunitetit. Këto konsiderohen si mjete që mund të plotësojnë hapësirat e lëna nga fondet buxhetore, duke siguruar financim të qëndrueshëm për objektivat e agROtech.

Imazh i mirë publik – Imazhi i mirë publik krijon mundësi të shumta prandaj edhe duhet ruajtur dhe duhet përforcuar. Në sajë të tij rritet mbështetja e publikut ndaj iniciativave dhe aktiviteteve të ndryshme, rriten shanse për donacione dhe financime të tjera, përforcohet lidhja me komunitetin.

Aktivitete trajnimi dhe promovimi të stafit – Stafi ka nevojë të vazhdueshme për zhvillim për t'u njohur më praktika të reja prandaj programe të vazhdueshme trajnimi janë të domosdoshme për të mbështetur zhvillimin afatgjatë të agROtech.



ASDO
ALBANIA SUSTAINABLE
DEVELOPMENT ORGANIZATION

Përfshirje më e lartë e grupeve të marxhinalizuara në aktivitetet e agROtech – Përfshirja më e madhe e grupeve më të disavantazuara të popullsisë, si personat me aftësi të kufizuara, në aktivitetet e agROtech do të ndikonte fuqishëm në përfundimin e imazhit publik të qendrës, por edhe do të krijonte një linjë të re aktivitetesh për t'u eksploruar, zbatuar dhe promovuar.

Kërcënimet/rreziqet

Mungesa e financimit të qëndrueshëm – E cilësuar edhe më parë, mungesa e burimeve të financimit të qëndrueshëm përbën një rrezik në mbështetjen e aktivitetit të agROtech në të ardhshmen. Është e rëndësishme që të shqyrtohen mundësi të reja financimi që të sigurojnë një burim të qëndrueshëm për të ardhmen e qendrës dhe për t përfunduar pavarësinë e saj të ushtrimit të aktivitetit.

Probleme politike – Shpesh ciklet politike krijojnë praktika të reja menaxhimi të cilat mund të kërkojnë riorganizimin e institucioneve të ndryshme.

Probleme me mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe prishjen e pajisjeve– Shpesh pajisjet teknologjike në mungesë të informacionit se si përdoren dhe për shkak të sjelljes jo të hijshme pa shkak të personave të ndryshëm mund të dëmtohen. Kjo shkakton më shumë presion mbi aktivitetet e mirëmbajtjes dhe kosto shtesë.

5 Plani i veprimit

Monitorimi i strategjisë

Sistemi i monitorimit dhe vlerësimit kërkon përpjekje të përkushtuara, ekspertizë, aftësi, vlerësim dhe menaxhim të mirë. Ky proces konsiderohet si një nga më të rëndësishmit gjatë periudhës së zbatimit të një dokumenti strategjik, pasi shmang devijimet nga përmbushja e objektivave 2023- 2026.

Monitorimi i zbatimit të strategjisë do të realizohet në disa nivele:

- ✓ Bashkërendimi i punës së qendrës me objektivat e përgjithshme strategjike në fushën e start-upeve të vendosura nga qeveria;
- ✓ Bashkërendimi i punës së qendrës me objektivat e përgjithshme zhvillimore të Bashkisë Roskovec;
- ✓ Shqyrtimi i kujdesshëm i gjithë dokumentacionit mbështetës në funksionimin e qendrës;
- ✓ Aktiviteti dhe përgjegjësitë e stafit të angazhuar në drejtimin dhe funksionimin e qendrës;
- ✓ Procesi i rekrutimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore;
- ✓ Përdorimi dhe mirëmbajtja e kujdesshme e pajisjeve dhe mjeteve të tjera të punës që shërbejnë për funksionimin e qendrës;
- ✓ Mirëmbajtja e platformës, monitorimi i kujdesshëm informacionit për t'u publikuar në platformë dhe nxitja e pjesëmarrjes së sipërmarrësve në platformë.

Monitorimi do të fillojë nga procedurat administrative për të siguruar raporte mbi zbatimin e projekteve të ndryshme; pastaj gradualisht do të përmirësohet cilësia e informacionit të krijuar gjatë procesit dhe përfundimisht ky informacion do të përdoret në sistemin e vendimmarrjes. Në varësi të ecurisë së punës mund të propozohen edhe rishikime të objektivave strategjike.

Mbështetja e startup-eve dhe priorizimi i projekteve të tyre

agROtech do të shërbejë si një mjedis mbështetës dhe udhëzues për të gjithë sipërmarrësit dhe të rinjtë me ide inovatore. Prandaj, në përputhje me parimet e qendrës, ofrimi i konsulencës së vazhdueshme në rritjen profesionale të inovatorëve të rinj është një objektiv i

përhershëm i zhvillimit të aktivitetit. Idetë inovatore do të mund të zhvillohen në mjediset e qendrës, e cila do të transformohet në një Hub të mirëfilltë, që do të lehtësojë zhvillimin e idesë dhe rrugëtimin e saj drejt themelimit të një startup-i. Ky proces do të planifikohet dhe monitorohet imtësisht për të siguruar një udhërrëfyes të suksesshëm për të rinjtë dhe inovatorët. Përzgjedhja e ideve më të mira, të cilat do të mbështeten nga skemat e financimit që do të krijohen brenda qendrës sipas parimeve të sipërpërmendura, do të realizohet nëpërmjet një procesi sistematik. Vendimmarrja e drejtë do të jetë në themel të procesit.

Në kushtet e një spektri të gjerë të projekteve konkurruese dhe ideve inovatore është e nevojshme vendosja e kriterëve për prioritizimin e projekteve. Kjo është veçanërisht e domosdoshme në kushtet e financimit të kufizuar.

Studimet ekonomike kanë përdorur analizën kosto-përfitim (AKP) si një mjet për vlerësimin e projekteve të ndryshme. Në thelb, përdorimi i kësaj metodologjie nënkupton krahasimin e kostove të projekteve/aktiviteteve me përfitimet që vijnë nga zbatimi i projektit/aktivitetet. Fazat kryesore të zbatimit të AKP, janë:

- i. *Faza 1: Vlerësimi i mundësive.* Kjo fazë qartëson objektivat e ndërhyrjeve dhe përcakton grupin e aktiviteteve potenciale që mund të plotësojnë objektivat e vendosura.
- ii. *Faza 2: Mbledhja e informacioneve mbi kostot dhe përfitimet.* Procesi i AKP synon zgjedhjen e veprimit që ofron përfitimet më të mëdha për njësi të kostos, apo, e thënë ndryshe (nëse përdoret kriteri kosto-efektivitet), veprimin që plotëson objektivin e vendosur me koston më të ulët.
- iii. *Faza 3: Përcaktimi i vlerës aktuale të përfitimeve neto.* Në shumicën e projekteve, kostot e aktiviteteve dhe përfitimet e projektit normalisht ndodhin përgjatë një periudhe të caktuar kohore (disa vjet) dhe mënyra më e përshtatshme për t'i përdorur këto vlera është kthimi i tyre në kohë në një vit të përbashkët. Kjo përfaqëson gjetjen e vlerës aktuale (neto). Ky proces quhet aktualizim dhe norma që përdoret për të konvertuar vlerat e ardhshme në vlera të tashme është norma e aktualizimit. Vlera aktuale neto (VAN) e një investimi llogaritet në funksion të përfitimeve, kostove dhe normës së aktualizimit.
- iv. *Faza 3: Përcaktimi i kriterit të zgjedhjes dhe analiza e ndjeshmërisë.* Masa apo projekti me VAN më të lartë, normalisht do të përzgjidhet si projekti më i mirë. Projektet me VAN pozitive përfaqësojnë mundësi eficiente investimi, përderisa përfitimet ndërkohore janë më të mëdha se kostot.

v. *Faza 3: Identifikimi i efekteve të shpërndarjes.* Një VAN pozitive përcakton ndërmarrjen e një projekti të mirë, megjithatë ajo nuk tregon asgjë në lidhje me shpërndarjen relative të kostove dhe përfitimeve totale të një investimi.

vi. *Faza 3: Marrja e vendimit.* AKP dhe metodat e tjera të lidhura me të, përcaktojnë bazën për vendimmarrje.

Shumë nga aktivitete e agROtech në vitet e para të implementimit do të jenë projekte në fushën rritjes së kapaciteteve apo dhe të edukimit. Në projekte të tilla, flukset dalëse përfaqësohen nga kostot e zbatimit. Këto kosto në shumicën e rasteve ndodhin në fillim të projektit, pra përfaqësojnë kosto fikse të zbatimit, si kostot e trajnerëve, të blerjes së një software specifik, vlerësimit të tregut etj. Krahas tyre, sigurisht duhet të merren në konsideratë edhe kosto të tjera të ndryshueshme, të cilat ndodhin përgjatë gjithë jetës së projektit dhe përfaqësohen kryesisht nga kostot e mirëmbajtjes.

Vlerësimi i projektit do të vështirësohet në momentin kur lind detyra e llogaritjes së përfitimeve në komunitet. Është shumë e rëndësishme të sqarohet se përfitimet do të jenë afatgjata dhe do të ndikojnë në dy fusha parësore si e inovacionit dhe sektorit agro.

Analiza kosto përfitim mund të shërbejë si një mjet shumë i dobishëm në vlerësimin e projekteve të ndryshme të agROtech dhe në prioritizimin e tyre. Ajo në tërësi do të mbështesë procesin e vendimmarrjes.

Vendimmarrja, konsultimet publike dhe pjesëmarrja e komunitetit

Vendimmarrja në agROtech realizohet si reflektim i kërkesave dhe udhëzimeve në disa nivele. Objektivat e përgjithshme, në raport edhe me buxhetin e akorduar, përcaktohen nga Bashkia e Roskovecit. Më tej objektivat specifike shpërndahen nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm për secilën Drejtori. Hartimi i këtyre objektivave është i kushtëzuar nga buxheti i akorduar nga Bashkia e Roskovecit, por njëkohësisht në to' janë reflektuar edhe kërkesat e sipërmarrësve apo të rinjve të qytetit. Kërkesa specifike mund të vijnë edhe nga vetë biznesit, në sektorë ku evidentohen nevoja për ndërhyrje. Në shtojcën nr. 1 të kësaj strategjia janë propozuar disa aktivitete për t'u përmbushur në periudhën 2023-2026 me qëllim sigurimin e qëndrueshmërisë së aktiviteteve dhe shërbimeve të Qendrës agROtech.

Në fakt, procesi i konsultimit publik është një shtyllë e realizimit të aktivitetit të agROtech. Bashkia Roskovec me drejtorinë përkatëse, është aktive në këtë drejtim për të mundësuar komunikimin efektiv me komunitetin.



Projektet prioritetizohen duke u bazuar në nevojat e komunitetit përkatës për aktivitete ngritje kapacitetesh apo lehtësim të sipërmarrjes si edhe burimet e financimit. Prezenca dhe kërkesat e donatorëve në disa raste mund të krijojnë një linjë të re aktiviteteve, të paplanifikuara, për të përmbushur kërkesat e komunitetit apo dhe të tyre si financues të aktivitetit. Analiza e kostos përfitimit e përshkruar më sipër do të përdoret sistematikisht si një mjet për të drejtuar procesin e vendimmarrjes dhe prioritetizimit të projekteve.

Shtojca 1: Propozimi mbi planin e aktiviteteve për t'u përmbushur nga Bashkia Roskovec për të siguruar qëndrueshmërinë e Qendrës agROtech

Objektivat	Aktivitete	Koha	Burimi i Financimit dhe partnerët potencial
Objektivi I: Sigurimi i programeve dhe shërbimeve inovatore, të diversifikuara, gjithëpërfshirëse dhe të aksesueshme nga inovatorët, bizneset mikro dhe të vogla dhe të rinjtë;	Aktiviteti 1: Organizimi i trajnimeve dhe workshopeve me të rinj, e sipërmarrësit në fushën e teknologjisë së informacionit dhe zhvillimit të qëndrueshëm.	2023, 2024, 2025, 2026	Donator kombëtarë dhe ndërkombëtar, Bashkia Roskovec, Ministrinë e linjës Sipërmarrës të huaj
	Aktiviteti 2: Organizimi i aktiviteteve të rrjetëzimit mes ekspertëve në fushën agro dhe të teknologjisë dhe sipërmarrësve të rinj (të tilla si panairë, vizita studimore pranë bizneseve)	2023, 2024, 2025, 2026	Bashkia Roskovec, Donatorë ndërkombëtar dhe kombëtar, Ministrinë përkatëse që mbulojnë sektorin agro, rininë dhe sipërmarrësit
	Aktiviteti 3: Shpërndarja tek të rinjtë dhe sipërmarrësit e pyetësorëve për të vlerësuar nevojat për ngritje kapacitetesh (së paku një herë në vit do të shpërndahen pyetësorë për të vlerësuar nevojat e të rinjve dhe sipërmarrësve).	2023, 2024, 2025, 2026	Bashkia Roskovec
	Aktiviteti 4: Ofrimi i shërbimeve lehtësuese për sipërmarrësit e rinj, si p.sh ofrimi i pajisjeve dhe programeve specifike për t'u përdorur pranë qendrës agROtech	2023, 2024, 2025, 2026	Bashkia Roskovec Donatorë kombëtar e ndërkombëtar
	Aktiviteti 5 : Ofrimi i shërbimeve të mirëmbajtjes së pajisjeve, (së paku 3 shërbime mirëmbajtje në vit nga stafi i teknologjisë së informacionit pranë Bashkisë Roskovec).	2023, 2024, 2025, 2026	Bashkia Roskovec me specialistët e IT-së
Objektivi II: Diversifikimi i strategjive dhe burimeve të	Aktiviteti 1: Organizimi i workshopeve me institucionet financiare mbi burime	2023, 2024, 2025,	Bashkia Roskovec, Institucione financiare bankare dhe jo bankare



ASDO
ALBANIA SUSTAINABLE
DEVELOPMENT ORGANIZATION

financimit për aktivitetet dhe shërbimet e ofruara nga agROtech ;	të ndryshme financimi ku sipërmarrësit e sektorit agro mund të aplikojnë	2026	
	Aktivitet 2: Organizimi i trajnimeve në fushën e edukimit financiar për sipërmarrësit e rinj	2023, 2024, 2025, 2026	Bashkia Roskovec në bashkëpunim me institucione të arsimit të lartë në vend
	Aktiviteti 3: Organizimi i trajnimeve mbi ngritjen e fondeve dhe hartimin e projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare për koordinorët e qendrës agROtech	2023, 2024, 2025, 2026	Organizata të shoqërisë civile që operojnë në fushë
	Aktivitet 4: Aplikimi në thirrje të ndryshme në kuadër të programeve kombëtare dhe ndërkombëtare	2023, 2024, 2025, 2026	Bashkia Roskovec, Donator kombëtar dhe ndërkombëtar
Objektivi III: Mbështetja dhe investimi në zhvillimin e kapaciteteve njerëzore përmes trajnimeve praktikave, dhe workshopeve.	Aktiviteti 1: Organizimi i trajnimeve dhe workshopeve me të rinj, e sipërmarrësit në fushën e teknologjisë së informacionit dhe zhvillimit të qëndrueshëm.	2023, 2024, 2025, 2026	Donator kombëtarë dhe ndërkombëtar, Bashkia Roskovec, Ministrinë e linjës Sipërmarrës të huaj
Objektivi IV: Zgjerimi dhe përforcimi i partneriteteve me aktorë të botës së biznesit dhe me grupe të tjera interesi;	Aktiviteti 1: Organizimi i panairëve të ndryshme pranë qendrës agROtech	2023	Bashkia Roskovec në bashkëpunim me sipërmarrës të ndryshëm
	Aktiviteti 2: Organizimi i aktiviteteve promovuese të sipërmarrësve të rinj me sipërmarrës të mëdhenj në vend, rajon dhe me gjerë.	2024	Bashkia Roskovec në bashkëpunim me sipërmarrës të ndryshëm
	Aktivitet 3: Pjesëmarrja e koordinorit të qendrës agROtech në aktivitete rrjetëzimi të organizuara nga donatorë të ndryshëm	2023, 2024, 2025, 2026	Bashkia Roskovec
Objektivi V: Zhvillimi dhe zbatimi i një strategjie komunikimi që	Aktiviteti 1: Hartimi i një strategjie komunikimi dhe plani komunikimi mbi	2023, 2024, 2025,	Bashkia Roskovec, Ekspertë nga organizata kombëtare, bashkëpunim me



ASDO
ALBANIA SUSTAINABLE
DEVELOPMENT ORGANIZATION

<p>thekson imazhin, përmirëson pozicionimin dhe promovon aktivitetet dhe shërbimet e agROtech.</p>	<p>aktivitet dhe shërbimet që ofron qendra agROtech</p>	2026	institutet e arsimit të lartë në vend.
	<p>Aktiviteti 2: Shpërndarja e informacionit dhe aktiviteve të organizuara pranë qendrës agROtech me anë të mekanizmave të ndryshëm të komunikimit</p>	2023, 2024, 2025, 2026	Bashkia Roskovec



ASDO
ALBANIA SUSTAINABLE
DEVELOPMENT ORGANIZATION

Shtojca 2: Indikatorët e monitorimit të planit strategjik të Qendrës agROtech për t'u përmbushur nga Bashkia Roskovec për periudhën 2023-2026

		Indikatorët e verifikueshëm	Burimet e verifikimit
Objektivat strategjikë	<p>Objektivi I: Sigurimi i programeve dhe shërbimeve inovatore, të diversifikuara, gjithëpërfshirëse dhe të aksesueshme nga inovatorët, bizneset mikro dhe të vogla dhe të rinjtë;</p> <p>Objektivi II: Diversifikimi i strategjive dhe burimeve të financimit për aktivitetet dhe shërbimet e ofruara nga agROtech ;</p> <p>Objektivi III: Mbështetja dhe investimi në zhvillimin e kapaciteteve njerëzore përmes trajnimeve praktikave, dhe workshopëve;</p> <p>Objektivi IV: Zgjerimi dhe përforcimi i partneriteteve me aktorë të botës së biznesit dhe me grupe të tjera interesi;</p> <p>Objektivi V: Zhvillimi dhe zbatimi i një strategjie komunikimi që thekson imazhin, përmirëson pozicionimin dhe promovon aktivitetet dhe shërbimet e agROtech.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Rritja e njohurive dhe aftësimin të të rinjve në fushën e teknologjisë së informacionit dhe zhvillimit të qëndrueshëm duke u kujdesur dhe për përfaqësimin gjinor në grupin e synuar. - Rritja e bashkëpunimit ndërmjet të rinjve dhe biznesit. -Rritja e numrit të start-upeve në Bashkinë e Roskovecit. -Rritja e numrit të shërbimeve lehtësuese për sipërmarrësit e rinj në Bashkinë e Roskovecit. -Rritja e numrit të bashkëpunimeve me sektorin e biznesit dhe Bashkisë Roskovec. 	<ul style="list-style-type: none"> -Numri i të rinjve që do të marrin pjesë në workshopet/trajnimet pranë Qendrës agROtech. -Numri i sipërmarrësve që do të marrin shërbime lehtësuese nga qendra agROtech. -Numri i start-upeve dhe ideve novatore që do të zhvillohen pranë kësaj qendre.

Objektivat specifikë

- Miradministrimi i këndit agROtech dhe i pajisjeve të instaluara;
- Ngritjen e kapaciteteve teknike të punonjësve dhe specialistëve të qendrës për mirëmbajtjen dhe organizimin e aktiviteteve në të ardhmen;
- Evidentimi i nevojave për ngritje kapacitetesh në të ardhmen për komunitetin e sipërmarrësve dhe të rinjve të Bashkisë Roskovec;
 - Hartimi i projekteve sipas fushave parësore dhe ngritja e fondeve për mbështetjen e start-ujeve në fushën agro apo dhe të teknologjisë;
 - Dhënia në përdorim e pajisjeve dhe infrastrukturës së qendrës sipërmarrësve të rinj apo dhe startup-eve për aktivitete të ndryshme, të cilat do t'i lehtësojnë procesin e të bërit biznes;
 - Promovimi e të rinjve të talentuar dhe të pasionuar pas teknologjisë, duke u krijuar mundësi dhe shërbime për aktivitete krijuese dhe novatore;
 - Konsultimi me komunitetin, që do të evidentojë fusha të reja veprimi, aktivitete të reja për komunitetin, linja të reja shërbimesh në funksion të kërkesave të sipërmarrësve dhe të rinjve;
 - Zhvillimi i mekanizmave të reja të financimit, të cilat synojnë financimin e aktiviteteve të start-ujeve dhe të vetë qendrës;
 - Promovimi i infrastrukturës së këndit agROtech për përthithjen e eventeve të rëndësishme me pjesëmarrje të sipërmarrësve apo dhe organizatave jo fitimprurëse;

- Numri i shërbimeve të mirëmbajtjes së pajisjeve, (së paku 3 shërbime mirëmbajtje në vit nga stafi i teknologjisë së informacionit pranë Bashkisë Roskovec).
- Numri i trajnimeve të stafit të teknologjisë së informacionit dhe koordinitorit të Qendrës agROtech (në varësi të aktiviteteve që do të realizohen por së paku 1 herë në vit).
- Numri i pyetësorëve të shpërndarë tek të rinjtë dhe sipërmarrësit për të vlerësuar nevojat për ngritje kapacitetesh (së paku një herë në vit do të shpërndahen pyetësorë për të vlerësuar nevojat e të rinjve dhe sipërmarrësve).
- Numri i projekteve ku Bashkia Roskovec do të aplikojë në të ardhmen për të siguruar qëndrueshmërinë e Qendrës agROtech dhe të shërbimeve të saj (së paku në dy projekte në vit do të aplikohet për të siguruar fonde për mirëmbajtje apo financimin e aktiviteteve edukuese/trajnuese, dhe mbështetëse për Startupet).
- Numri i trajnimeve të ofruara për të rinjtë (së paku 5 trajnime/module në vit do të ofrohen për të rinjtë e qytetit dhe sipërmarrësit e rinj në fushën e teknologjisë)
- Numri i aktiviteteve që do të organizohen pranë Qendrës agROtech (së paku 10 aktivitete në vit në fushën e teknologjisë së informacionit, marketingut digjital dhe komunikimit do të realizohen pranë qendrës).
- Numri i të rinjve të regjistruar në trajnime (objektivi 100 të rinj në vit)

- Raporti i mirëmbajtjes i dorëzuar nga stafi.
- Evidenca të zhvillimit të trajnimit të tilla si materiale shoqëruese për trajnimet të shpërndara tek pjesëmarrësit.
- Procesverbalet e takimeve , aktiviteteve.
- Kurrikula e trajnimeve/ agjenda e aktiviteteve.
- Raporti i kënaqësisë së të rinjve dhe sipërmarrësve që do të ndjekin trajnimet apo aktivitete e ofruara pranë Qendrës agROtech.
- Lista e pjesëmarrësve në trajnime/aktivitete.
- Publikimi i lajmeve për shërbimet e ofruara pranë Qendrës agROtech në platforma komunikimi dhe në media.
- Raporti i kënaqësisë së sipërmarrësve të rinj për përdorimin e pajisjeve apo dhe të platformës së komunikimit agROtech.
- Numri i certifikatave të trajnimeve të lëshuara.



ASDO
ALBANIA SUSTAINABLE
DEVELOPMENT ORGANIZATION

	<ul style="list-style-type: none">- Promovimi i projekteve novatore të realizuara nga të rinjtë e talentuar apo dhe sipërmarrësit që kanë frekuentuar qendrën agROtech tek palët e interesit;- Ofrimi i një infrastrukture teknologjike duke dhënë me qira pajisjet me kosto me të ulët;- Ofrimi i një platforme komunikimi për përmirësimin e infrastrukturës për sipërmarrësit e rinj.	<ul style="list-style-type: none">-Numri i aktiviteteve promovuese të qendrës dhe të projekteve të të rinjve të realizuara pranë qendrës (së paku dy aktivitete promovuese në çdo 6 muaj).-Numri i aktiviteteve pjesëmarrëse për sigurim fondesh për të mbështetur aktivitetet e qendrës ku stafi i agROtech do të jetë pjesëmarrës (së paku 2 aktivitete rrjetëzimi me donatorë të ndryshëm do të realizohen në vit apo ku stafi i bashkisë do të jetë pjesëmarrës).- Sasitë dhe cilësia e materialeve mësimore/didaktike (së paku 5 materiale trajnimi/ module/ materiale të shtypura në formën e materialeve mësimore do të prodhohen gjatë zhvillimit të trajnimeve për të rinjtë, në vit).- Numri i aktiviteteve promovuese të qendrës dhe pajisjeve pranë sipërmarrësve të Bashkisë Roskovec dhe të rajonit (së paku dy aktivitete promovuese në vit).-Numri i kompanive që do të regjistrohen pranë platformës së komunikimit agROtech (së paku 4 regjistrime të reja në platformë në vit).-Numri i ideve novatore dhe start-upeve të zhvilluara pranë Qendrës agROtech (së paku 4 ide start-upesh do të zhvillohen pranë kësaj qendre).	
--	--	--	--